



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA KOMUNA-
MALISHEVË/QKMF "DR. SHPËTIM ROBAJ" NË MALISHEVË



NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Në bazë të nenit 77 paragrafi 1 dhe 2, nenit 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197. Rregullores (QRK) -Nr.30/2024 Për Procedurën e Pranimiit Të Nëpunësve Të Shërbimit Publik Në Sektorin e Shëndetësisë. Në bazë Ligjit Për Pagat në Sektorin Publik Nr. 08/L-196 shtojcës 9 numër 13 si dhe në bazë të njoftimit të Masës Monetare të nr: 04/32 të datës: 16.01.2025 të Zyrës për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës QKMF- "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë shpall:

KONKURS PUBLIK PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS.

I. Titulli i vendit të punës: Mjek/e i/ e Përgjithshëm/e në QKMF-"Dr: Shpëtim Robaj"- Malishevë.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-DSHMS
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	(4) Katër.
Grada/ Koeficienti	H-10 - 7.4
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese	Gjashtë (6) muaj.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mjek/e i/e Përgjithshëm

- Ofron shërbime me standardë të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi.
- Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për pacientin nën mbikëqyrjen e mjekut familjar.
- Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrjen e Mjekut Familjar.
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë
- Kujdesi për personat në nevojë
- Mbanë kujdestari gjatë vikendit dhe natën.

- Mbanë orarin prej 40 orë ne javë sipas Ligjit Për Zyrtarët Publik dhe Ligjit të Punës.
- Edukimi shëndetësor etj.
- Udhëheq me ditarin e punës ditore të vizitave si dhe Regjistrimin e të dhënave në SISH.
- Për punën e vet i përgjigjet Drejtorit dhe Shefit të Sektorit të Mjekësisë Familjare.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë drejtimi i Përgjithshëm (kopjen e noterizuar)
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar nga MASHT:
- Licencën e punës me afat (kopjen e noterizuar).
- Formulari i aplikimit i plotësuar (origjinalin)
- Rezymeja personale (CV):
- Certifikatën e lindjes: (Origjinalin)
- Certifikatën që nuk është nën hetime ose i dënuar në Gjykatë (origjinalin).
- Letërnjoftimin e fotokopjuar:
- Certifikatën e mjekut për punë (Pas përzgjedhjes nga Komisioni):
- Përvoja e punës (e dëshirueshme).

Dokumentet duhet të jenë të kompletuara siç janë të renditura më lartë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

- Testimi me shkrim deri në 70 pikë
- Intervistimi deri në 30 pikë

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike, aplikacionet dorëzohen nga data 16.01.2025 deri me dt: 14.02.2025. Aplikacionet merren dhe dorëzohen ne Administratën e QKMF-së ditëve të punës, e hënë e premte prej: 08-00 deri ora 14/00. Aplikacioni mund te shkarkohet edhe ne linkun e më poshtëm.

- Konkursi shpallet në linkun: <http://konkursi.rks-gov.net> si dhe në tabelën e shpalljeve ne K.K-Malishevë dhe në QKMF. Të gjitha njoftimet e tjera dhe shpalljet vendosen në tabelën e shpalljeve në QKMF- Malishevë si dhe në Web faqen e komunës së Malishevës
- Informacione te sakta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat dëshmohen me dokumente.
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Malishevë datë:
16.01.2025

DREJTORI I QKMF-së
Dr. Afrim Krasniqi, Spc. Mjek Familjar

